



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:261810

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520909

C.nr. 1256/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.K nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati A.M nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 1,046.00 euro, jashtë seancës, më datën 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses A.K.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.K nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 01.09.2021 e deri më datën 20.11.2022 për 343 ditë pune të ja paguajë shumën prej 686.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 24.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses A.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 686.00 euro deri në shumën prej 1,046.00 euro dhe atë për shumën prej 360.00 euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses A.K, t'i paguajë shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A.K, më datën 24.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 1,046.00 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune si mësimdhënëse në SHMFU “Vëllezërit Frashëri”, në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit, ku edhe është duke punuar në këtë institucion, e që duke llogaritur për periudhën kohore nga data 01.09.2021 deri më 20.11.2022, paditëses i takon e drejta e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, shuma prej 2 euro, por që deri më tani nuk është kompensuar. Në bazë të lartcekurave dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të punës përkatësisht nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 21.01.2021, e cila përcakton kompensim për ushqim gjatë punës. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 07.03.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi, padia e paditëses nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore, ashtu që e drejta e kompensimit mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse rezulton se është e pavlefshme. Paditësja ka ushtruar padi në gjykatë me 24.11.2023, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.09.2021 – 20.11.2022, me mbështetjen në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021. Duke shtuar se kërkesëpadinë e konteston në tërësi edhe mbi bazën se më 21.11.2022 MASHT-i, ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 227/05, e datës 01.09.2021 dhe kontratën e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 281/05, e datës 01.09.2022, të lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses A.K dhe vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 332/05, i datës 18.10.2023, i lëshuar nga SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, në fshatin Drenoc.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë.

Me administrimin e kontratës të punës për mësimdhënëse me nr. të protokollit 227/05, e datës 01.09.2021 dhe kontratës të punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 281/05, e datës 01.09.2022, të lidhura ndërmjet paditëses A.K dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. Nr. 332/05 i datës 18.10.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.K, në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 343 ditët e punës, ndërsa në periudhën kohore prej datës 23.11.2022 e deri më datën 21.11.2023 ka prezantuar në punë në 180 ditët e punës.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë së paditëses për faktin në periudhën kohore nga data datës 01.09.2021 e deri më datën 20.11.2022 në vendin e saj të punës paditësja A.K ka prezantuar në 343 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësja ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 343 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditëses A.K, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 686 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses në pjesën tjetër dhe atë për 180 ditë të prezencës në punë, në shumën prej 360.00 euro, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditëses nuk i takon kompensimi i ushqimit në punë për periudhën kohore nga data 22.11.2022 deri me datën 20.11.2023, për faktin se sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme, të datës 09.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, duhet trajtuar deri me datën 21.11.2023, kur edhe kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve nënshkruese. Andaj, duke marr parasysh faktin se periudha e kërkuar për kompensim nga data 22.11.2022 deri me datën 20.11.2023, përfshin periudhën kohore kur Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 nuk ka qenë në fuqi, gjykata e ka refuzuar kërkesës për kompensimit të ushqim lidhur me këtë periudhë kohore, në mungesës se bazës ligjore.

Gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në*

*vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr.1256/2023, më datën 28.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.